

MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCËS NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË

BYROJA PËR ZHVILLIMIN E ARSIMIT

PROGRAMI MËSIMOR

Gjuhë dhe letërsi shqipe për gjimnazet-viti i parë



Shkup, maj 2001.

1. IDENTIFIKIMI I TË DHËNAVE

1.1. Emërtimi i lëndës mësimore: Gjuhë dhe Letërsi Shqipe

1.2. Drejtimi dhe profesioni arsimor

1.2.1. Drejtimi arsimor: Për gjimnazet

1.3. Diferencimi i lëndës mësimore

1.3.1. Arsimitimi i përgjithshëm: lëndë e përgjithshme

1.4. Viti i mësimit të lëndës mësimore

1.4.1. Viti i parë (I)

1.5. Numri i orëve të lëndës mësimore

1.5.1. Numri i orëve javore (kontakti javor) 4 orë

1.5.2. Numri i orëve vjetore (kuota e të mësuarit) 144 orë

1.6. Statusi i lëndës mësimore

1.6.1. Mësimi i detyrueshme

2. QËLLIMI I LËNDËS MËSIMORE

2.1. Qëllimi i përgjithshëm i lëndës mësimore

Qëllimi i mësimit të gjuhës dhe letërsisë shqipe synon që nxënësit pasi të kryejnë shkollimin e mesëm gjimnazin, të aftësohen të komunikojnë në gjuhën letrare shqipe, t'i përvetësojnë karakteristikat thelbësore të letërsisë shqipe dhe asaj të përkthyer.

* t'i aftësojë për mësim të pavarur (vetëmësim).

Ky qëllim do të arrihet me anë të zbatimit të njohurive dhe aftësive.

Pos qëllimit të përgjithshëm të kësaj lënde mësimore, dukshëm përcaktohet edhe qëllimi i veçant i saj i cili shprehet përmes diturive dhe aftësive, që do të përshkruhen si vijon:

* të komunikojnë drejtë duke respektuar gjuhën letrare shqipe në jetën e përditshme, në nivel akademik dhe dhe në nivele të tjera.

* të zbatojë normat gjuhësore në jetën e përditshme (me gojë dhe me shkrim), në kontekst të caktuar konkret e profesional.

* të kultivojë vlerat letrare, aftësitë personale në jetën e përditshme dhe në karrierën profesionale.

2.1. Kontributi i mësimit në qëllimin e përgjithshëm arsimor

Me aftësinë e tyre për komunikim në gjuhën letrare shqipe në jetën e përditshme, në nivel akademik dhe në të përgjithshëm, nxënësit do të kontribuojnë realizimit të qëllimeve të përgjithshme mësimore.

Kontributi konkret i këtij qëllimi është:

- * të mund t'i zhvillojnë aftësitë e tyre individuale për përdorimin receptiv e produktiv të gjuhës letrare shqipe në formën e shkruar dhe atë gojore.
- * të fitojnë dituri socio-linguistike, që do t'u ndihmojë të mirëgjenden në situata të ndryshme.
- * të aftësohen për shkollim të mëtutjeshëm nëpër institucionet e arsimit të lartë në aspektin profesional e shkencor.
- * të njihen me karakteristikat e letërsisë shqipe dhe me veçantitë e letërsive të tjera që do ta ndihmojnë njohjen reciproke të kulturave.

Kontributi i mësimit në aftësimin profesional

Me aftësinë për të komunikuar në gjuhën letrare shqipe në kontekste profesionale, nxënësit do t'i kontribuojnë përmbushjes së qëllimit në fushë të përgatitjes profesionale.

Kontributi konkret i këtij qëllimi është:

- * të mund të shfrytëzojnë literaturën e fushës së tyre profesionale (broshura, revista, fjalorë, doracakë).
- * të kenë mundësi edhe mëtej t'i përsosin aftësitë e tyre profesionale në sistemin e arsimit dhe aftësimin profesional, që po bëhet gjithnjë e më interdisciplinar dhe parakusht për kërkimin e informacioneve, mësimit dhe njohjes së gjuhës dhe letërsisë shqipe.

2.3. Kontributi i mësimit në zhvillimin individual të nxënësit

Për zhvillimin e aftësive personale është e nevojshme kariera profesionale dhe si qytetar, nxënësi do t'i kontribuojë përmbushjes së detyrave për zhvillimin personal.

Kontributi konkret i këtij qëllimi është:

- * të zhvillojnë nxënësit aftësitë e përgjithshme dhe ato të veçanta si: zgjidhjen e problemeve, aftësimin për bashkëpunim, përgjegjësinë, përshtatshmërinë dhe kreativitetin.
- * të formohet personalitet me zhvillim permanent të synimeve kognitive (arsimore), psiko-motorike (edukative) dhe afektive (funktionale), gjë kjo e rëndësishme për qytetarin e shoqërisë civile.

2.4. Qëllimi i veçantë i mësimit

Qëllimi i veçantë i mësimi të gjuhës dhe letërsisë shqipe në bazë të të cilit notohen nxënësit në fund të vitit shkollor , është ky:

- * të përvetësojnë materialin nga fusha e gjuhës dhe letërsisë shqipe.
- * të përvetësojnë fond të mjaftueshëm fjalësh që do të ndihmojnë komunikimin në gjuhën amtare letrare dhe do të jenë të kuptueshëm.
- * të aftësohen të gjejnë informacione konkrete nga sfera e gjuhës dhe letërsisë me karakter të me karakter të përgjithshëm ose personal.
- * të aftësohen të bartin informacione të shkruara ose letra që do të jenë të kuptueshme. Gjithashtu, nxënësit do të aftësohen për përthithjen e vlerave të letërsisë shqipe dhe asaj të përkthyer.

3. Njohuritë e nevojshme paraprake

Pasi nxënësit e kanë kryer shkollën fillore, supozohet se gjatë shkollimit të mesëm, gjimnazit, i kanë përvetësuar njohuritë, aftësitë dhe shkathësitë e mëposhtme:

- * të kuptojnë globalisht materien e gjuhës shqipe dhe kanë paranjohuri optimale mbi letërsinë shqipe dhe atë të përkthyer.
- * të zotërojnë fond të mjaftueshëm fjalësh dhe elementesh gramatikore që u mundëson shprehje të qarta.
- * të gjejnë informacione dhe elemente të ndryshme gjuhësore në tekste të caktuara dhe nga burime të ndryshme mund të vjelin informacione në sferën e komunikimit, gjuhës dhe letërsisë.

Megjithatë, duhet të potencohet se arsimtari patjetër ta ketë parasysh faktin se nxënësit dhe përkundër arsimit bazë, do të kenë nevojë për aftësim të mëtutjeshëm, veçmas në shkollat ku interesimi është më i madh.

4. PROCESI MËSIMOR

4.1. Struktura e përmbajtjeve mësimore

FUSHA PROGRAMORE: Të shprehurit dhe krijimtaria (30 ORË)				
Tërësitë tematike	Nr i orëve	Qëllimet konkrete Nxënësit:	Shënime didaktike	Korelacioni mes tërësive tematike dhe mes lëndëve
<p>Tregimi Ofrimi dhe kërkimi i ndihmës</p> <p>Unë dhe të tjerët</p>	6	<p>* të aftësohen të ndihmojnë ose të marrin ndihmën e të tjerëve në raste rreziqesh...;</p> <p>*të aftësohen ta pranojnë ndihmën dhe ta japin atë, jo si një element mëshirimi (gjë që mund ta godasë e fyejë palën që tentojmë ta ndihmojmë..), por si një akt mirësjelljeje e si një obligim qytetar e qytetërues...);</p> <p>* të njihen me shokët dhe të prezantojnë veten para tyre;</p> <p>* të aftësohen të flasin për veten dhe për rrethin e tyre me argumente.</p> <p>*Të nxiten të flasin pa frigë mbi çështje që pa nevojë mund të konceptohen si intim.</p> <p>*Të aftësohen të bëjnë debate të hapura të sinqerta dhe toleruese.</p> <p>*Të aftësohen të gjenden në raste</p>	<p>Kjo tërësi do të realizohet gjatë tregimit si formë e tregimit si formë e komunikimit.</p> <p>* do të sqarohet</p> <p>* do të ushtrohet me gojë dhe me shkrim.</p> <p>*Do të parashtrihen pyetje, situata, probleme.</p> <p>*Do të përdoren mjete mësimore: televizori, magnetofoni, kompjuteri.</p> <p>*Do të diskutohet,dramatizohet nëgrupe të vogla e të mëdha.</p>	<p>*Letërsia,gjuhësia,fonetika,morfologjia,sintaksa, drejtëshkrimi.</p>

Toleranca		<p>tolerant,të kultivojnë kulturën e dialogut, për të dëgjuar argumentet e tjetrit me vëmendje dhe gjer në fund(edhe atëherë kur nuk janë në të njëjtat valë me argumentet tona.</p> <p>*Të ushtrojnë të kultivojnë respektin me synim që ai të jetë i ndërsjelltë dhe të kuptojnë drejtë edhe interesin e tjetrit...</p>		
Mirësjellja		<p>*të aftësohen të kultivojnë sjelljen e mirë në punë e në jetë; qëndrimi i njerëzishëm, shpirtëmirësia,zemërbardhësia, dashamirësia.....</p> <p>*të aftësohen që të sillen drejtë edhe në situata të paprovuara më parë dhe të tregojnë mirësjellje ndaj rrethit të tyre të njohur e të panjohur (veçmas kur janë në</p>		
Intervista		<p>situatë të reprezentuesve jo vetëm të vetvetës.....)</p> <p>*të njihen me intervistën e një bisede me ndonjë njeri të shquar në ndonjë lëmi të jetës, me ndonjë person të rëndësishëm publik.</p> <p>*Të aftësohen për marjen e intervistave të sukseshme dhe për mënyrën se si të detyrohet i intervistuari që të mos ikë nga pyetjet eventuale që janë me interes të</p>		

<p>NJOFTIMI Të shkruajmë letra</p> <p>RADIO-TV</p>	<p>6</p>	<p>dorës së parë për intervistuesin.</p> <p>*Të njihen me teknikat e ndryshme të intervistimit të cilat i mundësojnë gazetarit parashtrimin e pyetjeve ngacmuese që do zgjojnë kureshtjen e lexuesve...</p> <p>*Të njihen me letrën, rëndësinë dhe formën e saj.</p> <p>*Të aftësohen të dallojnë letrën e zakonshme dhe atë të biznesit, të ushtrojnë të shkruajnë letra të thjeshta dhe të biznesit me të gjitha karakteristikat e tyre.</p> <p>*Të njihen me funksionimin e radios dhe të televizionit.</p> <p>*Të njihen me rolin që luan stafi udhëheqës në radio e televizion (kryeredaktori, redaktori, gazetari, lektori).</p> <p>*Të aftësohen të japin mendime e vlerësime për emisionet e radios dhe televizionit.</p> <p>*Të ushtrojnë të përgatitin emision, brenda</p>	<p>*përdoret njoftimi si formë e komunikimit.</p> <p>*Lexohet, shkruhet, diskutohet, njoftohet.</p> <p>*Përdoren mjete të nevojshme për ta realizuar këtë temë: grafoskopi, radioja magnetofoni, kamera, fletëza mësimore.</p> <p>*Parashtron pyetje problemore dhe krijon situata të ndryshme problemore.</p>	
--	-----------------	--	--	--

<p>REKLAMA</p> <p>*PËRSHKRI MI Përshkrim i një vepreje artistike</p> <p>Përshkrimi i</p>	<p>5</p>	<p>mundësive të shkollës.</p> <p>*Të njihen nxënësit me reklamën, ndërtimin dhe mesazhin që transmetohet.</p> <p>*Të ushtrojnë për të formuluar dhe shkruar reklama që kanë të bëjnë me profesionin që ushtrojnë.</p> <p>*Të aftësohen të bëjnë përshkrimin e një vepre të artit a të kulturës në përgjithsi.</p> <p>*Të ushtrohen që këtë ta bëjnë me fjalët e tyre dhe në mënyrë sa më të natyrshme.</p> <p>*Të aftësohen që gjatë përshkrimit të ndalen në esencën e gjërave dhe të njejtën ta japin me sa më pak fjalë.</p> <p>*Të aftësohen që përshkrimet e veprave artistike t'i bëjnë ashtu siç i kuptojnë vetë.</p> <p>*Të aftësohen që veprën letrare ta kuptojnë si polivalente(shumështresore) dhe kështu t'i bëjnë edhe përshkrimet (pavarësisht a përputhen ato me përshkrimet e të tjerëve...)</p> <p>*të aftësohen të përshkruajnë ngjarjet e</p>	<p>*Do të përdoret përshkrimi si formë e komunikimit.</p> <p>*Do të lexohet, diskutohet, shkruhet, hartohet...</p> <p>*do të organizohen ngjarje konkrete, piknik etj.Dhe do të krijohen situata të ndryshme nga jeta e nxënësve(qoftë emirë apo konfliktuoze)</p> <p>*Do të përdoret kamera, grafoskopi dhe mjete tjera mësimore.</p>	
---	-----------------	---	---	--

<p>një ngjarjeje të rëndësishme nga jeta</p> <p>Përshtypjet nga pikniku</p> <p>Gjatë vitit shkollor do të bëhen 4 hartime</p>	<p>8</p>	<p>rëndësishme të jetës, qofshin ato të ëmbla apo të hidhura,duke dhënë thelbin (esencën) e gjërave në mënyrë sa më të rrjedhshme e me një gjuhë sa më të kapshme e sa më të thjeshtë.</p> <p>*Të aftësohen ti përshkruajnë gjërat kryesore duke ikur prej elementeve të tepërta e më pak të rëndësishme.</p> <p>*Të aftësohen që të bëjnë një përshkrim të bukur të gjith asaj që kanë përjetuar gjatë një pikniku në natyrë,duke dhënë në mënyrë sa më koncize tiparat e natyrës, duke u ndalur në përjetimet më të këndshme dhe më të paharuara.</p> <p>*Të ushtrojnë që përshkrimi të jetë sa më letrar e me shprehje të zgjedhura e të figurshme...</p> <p>*të njihen me mënyrat e shkrimit të hartimeve, me stilet dhe gjuhën që është më e përshtatshme për një hartim të suksesshëm, me përdorimin e drejtë të shenjave të pikësimit.</p> <p>*Të aftësohen të bëjnë renditjen logjike</p>		
--	-----------------	---	--	--

		të gjërave-korelacionin e duhur dhe etapat e harimit (hyrja, pjesaqendrore, përfundimi) me futjen në përdorim të gjuhës së figurshme.		
Përmbajtjet	9	*Të aftësohen që të përdor shprehje dhe fraza sa më të kapshme që në fakt përcaktojnë qëllimin kryesor të hartimit. Fusha programore: Gjuhë 40 orë	Shënime didaktike	Korelacioni mes tërësive tematike dhe lëndëve
Njohuri të përgjithshme për gjuhën Gjuha dhe rëndësia e saj		Qëllimet konkrete Nxënësit duhet të aftësohen Qëllimet konkrete Nxënësit duhet të aftësohen	Për të realizuar këtë temë mësimore arsimtari do të përdorë këto aktivitete: - do të sqarojë - do të lexojë - do të grumbullojë materiale gjuhësore - do të krahasojë	Letërsinë, historinë e gjuhës, dialektologjinë, fonetikën, morfologjinë, sociologjinë, komunikimin.
Gjuha popullore dhe ajo letrare	9	*Të njihen me gjuhën si mjet komunikimi ndërmjet njerëzve, me gjuhën si sistem tingujsh e shprehjes	Do të përdorë format mësimore si: frontale individuale në çifte në grupe etj.	
Gjuha dhe degët		*Të njihen me gjuhësinë si shkencë që	Do të përdorë mjete të ndryshme	

<p>e saj</p> <p>Fonetika dhe fonologjia</p> <p>Objektii fonetikës</p> <p>Fonologjia</p> <p>Organet e të folurit</p> <p>Tingujt dhe fonemat</p> <p>Llojet themelore të tingujve</p>		<p>meret me studimin e gjithanshëm të gjuhës ndarjen e gjuhës në disiplina.</p> <p>*Të njihen me fonetikën si degë e gjuhësi-së, që për objekt studimi ka sistemin tingullor.</p> <p>*Të njihen me fonologjinë si degë e gjuhë-sisë së përgjithshme që studion tingujt si njësi më të vogla diferencuese të kupti-mit të fjalës.</p> <p>*Të njihen dhe të aftësohen të dallojnë organet e të folurit dhe funksioni i tyre në nyjëtimin e tingujve.</p> <p>*Të njihen me tingujt dhe shkronjat, me çka paraqiten tingujt, alfabetin e gjuhës shqipe.</p> <p>*Të njihen me llojet e tingujve, tingujt</p>	<p>mësimore si libra të gramatikës fletëza mësimore grafoskop, tekste të ndryshme të zgjedhura.</p> <p>Nga metodat do të përdorë atë të vëzhgimit, krahasimit, hulumtimit etj.</p> <p>Për të realizuar këtë temë arsimtari do të përdorë këto aktivitete:</p> <ul style="list-style-type: none"> - të sqaruarit - të lexuarit - rë grumbulluarit e materialit - të ushtruarit <p>Do të përdorë mjete mësimore si:</p> <ul style="list-style-type: none"> -librin e gramatikës, -grafoskopin, -episkopin, -fletëza mësimore dhe tekste të zgjedhura. <p>Format e punës frontale individuale në çifte në grupe etj.</p> <p>Metodat: analiza, sinteza, vëzhgimi, hulumtimi, përfundimi etj</p>	<p>*Letërsinë,gjuhësinë(fonetika, morfologjia, sintaksa) drejtëshkrimi, dialektologjia etnologjia, komunikimi etj.</p>
---	--	---	---	---

<p>Zanoret dhe klasifikimi i tyre</p>	<p>5</p>	<p>zanorë dhe bashkëtingëllore.</p> <p>*Të njihen me klasifikimin e zanoreve, përdorimin e drejtë të zanoreve i, u, y, dhetogjet e zanoreve</p>		
<p>Bashkëtingëlloret dhe klasifikimi i tyre</p>		<p>*të njihen me bashkëtingëlloret dhe klasifikimin e. tyre, togjet e bashkëtingëlloreve</p>		
<p>Rrokja</p>		<p>Të njihen me rrokjen dhe aftësohen të dallojnë rrokjen në fjalë, rrokjet e hapura dhe të mbyllura.</p>		
<p>Theksi</p>		<p>Të njihen me theksin, rrokjen e theksuar dhe të patheksuar, fjalët oksitone, paraoksitone dhe proparaoksitone.</p>		
<p>Sintaksa Fjalja e thjeshtë</p>		<p>Të njihen me fjalinë e thjeshtë e cila përmban një folje dhe pa folje.</p>		
<p>Kryefjala</p>		<p>Të njihen dhe aftësohen të dallojnë kryefjalën të dijnë mbi vendin e saj në fjali përshtatjen e saj me kallëzuesin.</p>		
<p>Kundrinori</p>		<p>Të njihen me kundrinorin dhe atë, me kundrinorin e drejtë dhe të zhdrejtë</p>		

<p>Kallëzuesori</p> <p>Rrrethanori</p> <p>Morfologjia</p> <p>Fjalë dhe pjesët e saj</p> <p>Rrënja e fjalës</p> <p>Tema e fjalës</p> <p>Parashtesat dhe prapashtesat</p> <p>Mënyra e formimit të fjalëve</p> <p>Fjalët e prejardhura</p> <p>Paranyjëzimi</p>	<p>22</p>	<p>rrolin e tyre, vendin e tyre në fjali dhe çka e dallon atë nga kryefjala.</p> <p>Të aftësohen të dallojnë kallëzuesorin e kryefjalës, rrolin e tij dhe vendin që zë në fjali.</p> <p>Të mund të dallojnë rrrethanorin, rrolin e tij, ndërtimin, vendin që zë në fjali.</p> <p>- të njihen me fjalët kuptimplota dhe jokuptimplota, pjesët e ndryshueshme dhe të pandryshueshme të ligjeratës.</p> <p>Të njihen me rrënjën e fjalës dhe dallimin e saj.</p> <p>Të njihen me temën e fjalës dhe dallimin e saj.</p> <p>Të njihen me parashtesat dhe prapashtesat, funksionin e tyre në formimin e fjalës.</p> <p>Të njihen me mënyrat e formimit të fjalëve dhe llojet e tyre.</p> <p>Të njihen me mënyrën e formimit të këtyre fjalëve, formimi i tyre me</p>	<p>Për realizimin e kësaj teme do të përdoren këto aktivitete:</p> <p>Të sqaruarit, të ushtuarit të hulumtuarit, të grumbulluarit e materialeve.</p> <p>Mjetet mësimore:</p> <p>fletëza mësimore, grafikone të ndryshëm, grafoskop, kompjuter episkop etj.</p> <p>Format:</p> <p>frontale, individuale, në çifte, në grupe.</p> <p>Metodat: analiza, sinteza, vëzhgimi, hulumtimi, përfundimi etj.</p>	<p>Letërsinë, historinë e gjuhës, dialektologjinë, fonetikën, morfologjinë, sociologjinë, komunikimin.</p>
---	-----------	---	--	--

<p>Fjalët e përbëra (kompozitat)</p> <p>Fjalët e përngjitura</p> <p>Formimi i fjalëve me konverion</p> <p>Kuptimet gramatikore dhe format gramatikore</p> <p>Emrat (kategoritë gramatikore)</p> <p>Gjinia e emrave-mashkullore dhe femërore</p> <p>Formimi i</p>		<p>parashtesa dhe prapashtesa.</p> <p>Të njihen me formimin e fjalëve me anë të nyjes së përparme dhe dallimin e këtij lloji të fjalëve.</p> <p>Të njihen me formimin e fjalëve me dy a më shumë tema, të dallojnë llojet e tyre.</p> <p>Të njihen me formimin e fjalëve të formuara historikisht si p.sh. atëherë etj</p> <p>Të njihen me kalimin e një fajle prej një pjese në një pjesë tjetër të ligjeratës pa kurfarë ndryshimi fonetik dhe morfologjik, si p. sh. krenar-e, popull krenar, trim-e, ushtar trim etj.</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ Të njihen me kuptimet gramatikore të pjesëve të ndryshueshme të ligjeratës që shprehen me anë të formave gramatikore. ➤ Të njihen me kategorinë gramatikore të gjinisë, të numrit, të rasës, dhe të shquarsisë dhe pashquarsisë së emrave. ➤ Të njihen me kategorinë gramatikore të gjinisë mashkullore, femërore, dhe asnjëanëse. 		
---	--	--	--	--

<p>shumësit të emrave</p> <p>Kategoria gramatikore e rasës</p> <p>Funksioni i nyjeve</p> <p>Folja- klasifimi</p> <p>Kategoritë gramatikore të foljeve</p> <p>Diateza e foljeve</p> <p>Mënyra dëftore e foljes</p> <p>Mënyra</p>		<p>➤ Të njihen me formimin e shumësit të emrave si me anë të parashtesave trajtëformuese , të ndërymeve fonetike në temën e emrit, me ndrimin e tingujve në temë dhe të parashtesave njëkohësisht, me disa emra që në njëjës dhe në shumës përdoren njësoj.</p> <p>Të njihen me rasat si kategori gramatikore dhe përdorimin e tyre</p> <p>Të njihen me nyjet e përparme në planin e tyre funksional, para cilëve pjesë të ligjeratës përdoren ato si p. sh. i aftë, i madh, i gjashti, të ecurit, etj.</p> <p>Të njihen me klasifikimin e foljeve ndihmëse, gjysëm ndihmëse dhe të zakonshme ose të mëvetësishme, që vet e kryejnë funksionin e kallzuesit.</p> <p>Të njihen me kategoritë gramatikore të foljeve dhe ato të vetës, numrit, diatezës, mënyrës dhe kohës</p> <p>Të njihen me përdorimin e foljes në diatezën veprorë, pësorë dhe vetvetore.</p>		
---	--	---	--	--

<p>lidhore e foljes</p> <p>Format e pashtjelluara të foljeve</p>	<p>Numri i Orëve</p>	<p>Të njihen me mënyrën dëftore, kohët e saj, të tashmen, të shkuarën dhe të ardhmen, përdorimin e foljeve në këto kohë.</p> <p>Të njihen me mënyrën lidhore të foljes, kohët e saj, përdorimi i drejtë gjatë të folurit dhe të shkruarit p. sh. jo të lexon, por të lexojë, të shkojë etj.</p> <p>Të njihen me format e pashtjelluara, përcjelloren, dhe paskajoren, përdorimin e drejtë të tyre në të folur dhe të shkruar.</p>	<p>SHËNIME DIDAKTIKE</p>	<p>KORELACIONIMES TËRËSIVE</p>
<p>Tërësia tematike</p>	<p>2</p>	<p>QËLLIMET KONKRETE</p>		

<p>I. Teori e letërsisë</p> <p>- Arti dhe zanafilla e tij. Llojet e artit. Letërsia dhe shkenca (historia e letërsisë, teoria e letërsisë dhe kritika letrare)</p> <p>Stili funksional dhe gjuha shqipe, gjuha kombëtare, gjuha letrare, stilet funksionale (tekniko-shkencor, administrati administrativ, publicistik, artistik etj.).</p> <p>Stili artistik, roli i figurës dhe stili, ekspresiviteti artistik</p>	<p>2</p>	<p>-të njohin dhe të zotërojnë letërsinë si art i fjalës, fillimin dhe zhvillimin e saj, llojet e artit, shkencat që merren me studimin e letërsisë.</p> <p>-të njohin, të zotërojnë dhe të dallojnë llojet e stileve (tekniko-shkencor, administrativ, publicistik, artistik etj.).</p> <p>të njohin dhe zotërojnë stilkun artistik dhe rolin e figurës artistike, ekspresivitetin artistik .</p>	<p>Këtë temë arsimtari do ta realizojë nëpërmjet këtyre aktiviteteve:</p> <p>-interpretimit, shpjegimit, leximit, sqarimit, zbatimit praktik, parashtrimit të pyetjeve etj.</p> <p>Do të zbatojë metodat mësimore: frontale, individuale dhe në grupe. Metodat mësimore: bisedës, analizën e sintezën si edhe sistemet mësimore :mësimin problemor dhe kërkimor.</p>	<p>TEMATIKE DHE LËNDËVE</p> <p>Letërsia (letërsia e përkthyer botërore) stilistika, folklori, teoria e letërsisë. Fushat programore: komunikimi, gramatika.</p>
---	-----------------	--	--	--

<p>Pastërtia, saktësi a, bukuria dhe pasuria e gjuhës në një vepër letrare</p>	<p>4</p>	<p>- të njohin dhe zotërojnë pastërtinë, saktësinë, bukurinë dhe pasurinë e gjuhës në një vepër artistike.</p>		
<p>II. Struktura e veprës letrare</p> <p>Përmbajtja dhe forma e veprës artistike. Tema dhe ideja e veprës letrare</p> <p>Subjekti, kompozicioni i veprës letrare.</p>	<p>3</p>	<p>- të njohin, të zotërojnë dhe të dallojnë përmbajtjen dhe formën e një veprë letrare, temën dhe idenë e një veprë letrare, subjektin dhe kompozicionin e një veprë letrare.</p>		
<p>III. Gjinitë dhe llojet letrare</p> <p>1 . Gjinia epike-</p>				

<p>shqiptare.Llojet e ndryshme të folklorit: lirika, epika historike dhe proza.</p> <p>Lirika. Lirika familjare,shoqërore.Veçoritë artistike.</p> <p>Epika legjendare. Eposi i kreshnikëve. Përmbajtja dhe baza historike. Personazhet dhe veçoritë artistike.</p> <p>VI. Letërsia shqipe</p> <p>Letërsia e vjetër</p>	<p>14</p>	<p>- të njohin dhe zotërojnë veçoritë artistike të lirikës familjare dhe shoqërore.</p> <p>-të njohin dhe zotërojnë këngët kreshnike,përmbajtjen dhe bazën historike,personazhet dhe veçoritë artistike nëpërmjet shembujve të përshatshëm si : "Gjegj Elez Alia"," Martesa e Halilit".</p> <p>- të njohin dhe zotërojnë shkrimet e</p>	<p>Kjo tërësi mësimore do të realizohet</p>	<p>Letërsia e vjetër shqipe,historia e letërsisë,historia e popullit shqiptar, komunikimi, gjuhësia etj.</p>
---	-----------	---	---	--

shqipe. Dokumentet e para të shkrimit të gjuhës shqipe.	2	para në gjuhën shqipe ("Formulën e pagëzimit", Fjalorthi IV.Harfit,Perikopeja e Ungjillit).	nëprmet këtyre aktivitetëve: -analizës, interpretimit, shpjegimit,komentimit,leximit,paras htrimit të pyetjeve.	Letërsia e vjetër shqipe ,historia e letërsisë,historia e popullit shqiptar. komunikimi,gramatika etj.
Zhvillimi i humanizmit shqiptar. 1.Marin Barleti.Jeta dhe veprimtaria letrare.Analizë e veprës "Historia e Skenderbeut".	1	-të njohin dhe zotërojnë paraqitjen e humanizmit në letërsinë shqipe dhe përfaqësuesin kryesor Marin Barletin,konceptin historik dhe figurën e Skenderbeut si njeri ,si atdhetar dhe si ushtarak në veprën "Historia e Skenderbeut", si edhe veçoritë stilistike.	Metodat mësimore: analiza e sinteza, metoda e tekstit, mësim problemor dhe kërkimor.	
2. Gjon Buzuku. Jeta dhe vepra. Meshari.	1	-të njohin dhe zotërojnë Buzukun,vlerën historike dhe gjuhësore të veprës "Meshari" si vepër e parë e plotë e shqipes së shkruar.		
3.Pjetër Budi. Jeta dhe vepra.		-të njohin dhe zotërojnë Budin si		

Doktrina e kërshenë.	1	vjershëtorin e parë të letërsisë shqipe, përpjekjet e tij për të krijuar një vepër artistike.		
4. Frang Bardhi				
Jeta dhe vepra. Fjalori Latinisht - Shqip. Apologjia e Skenderbeut	2	- Të njohin dhe zotërojnë veprimtarinë e F. Bardhit si strukturën dhe rëndësinë e "Fjalorit", si mbledhës i proverbave, ndjenjat kombëtare dhe patriotike të librit "Apologjia e Skenderbeut".		
5. Pjetër Bogdani				
Jeta dhe vepra. "Çeta e profetëve". Poezia e tij.	2	- Të njohin dhe zotërojnë veprimtarinë letrare të Bogdanit si prozator i parë në letrat shqipe, vjershat, stilin dhe gjuhën e tij.		
6. Jul Variboba.				
Jeta dhe vepra. Gjella e ShënMërisë virgjër.	2	- Të njohin dhe zotërojnë veçoritë artistike në lidhje me folklorin në poemën "Gjella e ShënMërisë Virgjër", si poemë e parë origjinale e letërsisë së vjetër arbëreshe dhe shqipe.		
7. Muhamet Çami.				
Jeta dhe vepra. "Erveheja".	2	- të njohin dhe zotërojnë trajtimin e temave laike, vlerat artistike dhe veçoritë gjuhësore të poemës "Erveheja".		

<p>8.Hasan Zyko</p> <p>Kamberi. Jeta dhe vepra. Vjershat.</p>	<p>15</p>	<p>- Të njohin dhe zotërojnë veçoritë artistike të poezisë satirike dhe elementet realiste në krijimtarinë e tij. (të komentojë vjershat Paraja dhe Trahanaja.</p>		
<p>VII. Letërsia botërore</p> <p>1.Pasqyrë për fillimet e letërsisë botërore .Mitologjia,përfaqësuesit dhe veprat kryesore "Gilgameshi".</p>	<p>2</p>	<p>- Të njohin dhe zotërojnë fillimet e letërsisë botërore, mitologjinë, karakteristikat themelore të mitologjisë, përfaqësuesit dhe veprat kryesore (Gilgameshi).</p>	<p>Kjo tërësi tematike do të realizohet nëpërmjet këtyre aktiviteteve: interpretimit, analizës, shpjegimit, leximit, komentimit, sqarimit.</p> <p>Metodta mësimore: Metoda e bisedës,analiza dhe sinteza, e tekstit, shpjegimit etj.</p> <p>Do të shfrytëzohet teknina e hulumtimit, vrojtimit, anketimit etj.</p> <p>Format e punës:</p> <p>Frontale,individuale, në grupe,në çifte .</p>	<p>Historia e letërsisë botërore (Letërsia e përkthyer e antikitetit).</p> <p>Fushat programore: Komunikimi dhe gjuhësia.</p>
<p>2.Homeri. Analizë "Iliada".Vlerat e poemave të Homerit.</p>	<p>4</p>	<p>- të njohin dhe zotërojnë vlerat artistike të poemës "Iliada",vendin dhe rolin e mitologjisë greke,personazhet kryesore - Akilin, Hektorin, Agamemnonin, Andromakën, elementet realiste në</p>		

3. Safo.Poezia e saj.	2	<p>vepër etj.</p> <p>- Të njohin dhe zotërojnë vlerat artistike të poezive të Safos,larminë e temave dhe mendimeve filozofike.</p>		
4. Eskili. Jeta dhe vepra. Tragjedia "Prometheu i lidhur".	2	<p>- Të njohin dhe zotërojnë karakteristikat artistike në veprën "Prometheu i lidhur",figurat e marra nga mitologjia, besimin në fuqinë e njeriut për të zotëruar fuqitë e natyrës.</p>		
5. Aristofani. Jeta dhe vepra. Analizë artistike e veprës "Bretkocat".	1	<p>- Të njohin veprat e komediografit më të madh të antikitetit nëpërmjet analizës së komedisë "Bretkocat",me luftën për të drejtën dhe të vërtetën nëpërmjet mjeteve të pasura të satirës.</p>		
6. Letërsia romake. Fillimet e letërsisë romake.	2	<p>-të njohin dhe zotërojnë fillimet e letërsisë romake,periudhat e saj.</p>		
7. Virgjili. Jeta dhe vepra. Analizë artistike e poemës		<p>- Të njohin dhe zotërojnë personazhet, shprehjet dhe mjetet stilistike të veprës</p>		

"Eneida"		"Eneida".		
----------	--	-----------	--	--

LISTA E LEKTYRAVE

Ismail Kadare	10 orë	„Kush e solli Doruntinën	<ul style="list-style-type: none"> Nxënësit të njihen me veprat më të rëndësishme të letërsisë shqipe dhe të përkthyer që janë në listën e lektyrave. Të aftësohen t’i vlerësojnë vlerat pozitive të veprave letrare në aspekt të përmbajtjes dhe formës. <p>Posaqërisht t’i analizojnë idetë e autorit në raport me kohën, vendin dhe temën që trajton. Gjatë vitit të analizohen shtatë vepra nga lista e paraparë sipas zgjedhjes së arsimtarit dhe nxënësve</p>
Abdylaziz Islami		„Hekurani në Artas	
Vaso Pasha		„Bardha e Temalit’’	
Sami Frashëri		„Dashuria e Fitnetes me Talatin	
Azem shkreli		„Karvani i Bardhë	
Murat Isaku		„Shara’’	
Lazgush Poradeci		„Poezi’’	
Agim Vinca		„Poezi’’	
Esad Mekuli		„Për ty’’	
Gligor Prliçev		„Skenderbeu’’-poemë	
Ernest Heminguej		„ Dëborra e Kilimanxharos	
Honore de Balzak		„Shtëpia misterioze	

4.2. Metodatat mësimore dhe aktivitetet për mësim

Metodologjia e propozuar e mësimimit bazohet në supozim se gjuha shqipe përdoret si lëndë mësimore gjatë orëve, gjer në shkallën më të lartë të arsimimit. Arsimtari patjetër të aplikojë metoda funksionale të mësimimit, me theks të veçantë në aktivitetet e nxënësve, që bazohen në interesimin e tyre me qëllim që të krijohen kushte të volitshme për mësim. Nga metodatat mësimore propozojmë të përdorë parasegjithash atë të bisedës, shpjegimit demonstrimit, punës me tekst etj.

Të respektojë karakterin shkencorë të të mësuarit, sistematizimin dhe gradualitetin si dhe të përpiqet të vë në zbatim lidhjen e teorisë me praktikën. Kështu sa i takon gjuhës është e rëndësishme që në mënyrë permanente të shkohet nga niveli funksional kaha ai sistematik, me qëllim që të ruhet motivimi i nxënësve për aplikimin të gjuhës letrare shqipe .

T'u mundësohet nxënësve sa më shumë që është e mundur, ta shfrytëzojnë gjuhën shqipe në kontekst funksional, si të arriturat si të arriturat gjuhësore ashtu edhe ato letrare me qëllim që të mundësohet aplikimi i tyre.

Nga format e punës është e udhës që pos formës frontale të përdoret edhe ajonë grupe, individuale dhe në çifte. Poashtu gjatë realizimit të materialit mësimor arsimtari duhet të përdor sa më shumë mjete mësimore vizuale (libra, fletëza mësimore, pyetësor revista për të rinj), teknikë (kompjuter, televizor, video, magnetofon, me anë të së cilëve vijë në shprehje aktivitetet e nxënësve.

Tema të tëra duhet të realizohen me anë të sistemit problemor, kërkimor aktiv të të mësuarit. Kështu aktivitetet e nxënësve do të vijë nëshprehje përmes: vrojtimit, dëgjimit, shënimit, ushtrimeve, leximit, zgjidhje të problemeve , qoftë ajo në formë grupore apo individuale, duke ardhur në shprehje puna e pavarur e nxënësve

4.3. Organizimi dhe realizimi i procesit mësimor

Sipas qëllimit të parashtruar lënda mësimore, realizohet në mësojtore të specializuar për mësim teorik, në dy gjysmëvjetorët, me orë javore, të detyrueshme. Puna e pavarur e nxënësve mund të realizohet në shkollë dhe në shtëpi si detyrë shtëpie.

4.4. Mjetet mësimore dhe ato ndihmëse

Për t'u realizuar qëllimi i lëndës Gjuhë shqipe dhe letërsisë me komunikim në shkollat e mesme profesionale i propozojmë mjetet mësimore:

1. Pajisjet e rëndomta: bankat ,kariget, dërrasat (tabelen).
2. Grafoskopin (mund të jetë i përbashkët për më shumë lëndë mësimore)
3. Vende për një ruajtje të sigurtë të kompleteve të paraleles dhe të librave me referenca (dollarape, rafte).
4. Përdorimi i Internetit ne hapësirat ku janë të instaluar kompjuterët.
5. Kasetofoni dhe videorekorderi ...(TV mund të jetë i përbashkët).

Gjatë realizimit të programit të lëndës së gjuhës shqipe dhe letërsisë me komunikim, nxënësve dhe arsimtarëve u sugjerohen librat dhe materialet:

1. Libri i leximit (viti i tretë).
2. Libri i gramatikës me komunikim (viti i tretë).
3. T eksti mbi teorinë e letërsisë dhe folklorin (viti i tretë).
4. Doracaku për nxënësit.
5. Doracaku për mësuesin.

6. Kopje të librave të sipërpërmendura dhe materiale për përdorim personal.
7. Parapagimi (përmes shkollës) i revistave të vlefshme profesionale.
8. Katalogë mbi materiale për mësimin e metodikës së gjuhës dhe letërsisë.
9. Përdorimi i fotokopjes dhe aparateve të tjera për shtypje.

5. NOTIMI DHE REZULTATET E NXËNËSVE

Nxënësit do të notohen në mënyre permanente gjatë tërë vitit dhe punës, testimi ekstern për notimin permanent, nxënësi duhet të vlerësohet me 8 nota gjatë vitit shkollor . K y numër i notave parashihet për dy semestra. Gjatë gjysëmvetorit të parë, 2 nota do të bazohen në teste dhe detyra të kontrollit, 4 nota do të bazohen në fushën e komunikimit dhe 2 nota do të jenë të hartimeve.

Aspekti gramatikor dhe ai i drejtshkrimit të gjuhës vlerësohet përmes testeve dhe detyrave të kontrollit.

Gjatë kontrollimit të njohurive të nxënësve me anë të testit, në rast mospasurisë, ato i nënshtrohen riprovimit.

6. P ARAKUSHTET MATERIALE DHE KADROVIKE PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË LËNDËS

6.1. Karakteristikat themelore të arsimtarit

Arsimtari i lëndës Gjuhë shqipe dhe letërsi me komunikim duhet të posedojë.

karakteristika personale, profesionale dhe pedagogjike të cilat janë:

- * të jetë i shëndosh fizikisht dhe psikikisht,
- * të njohë gjuhën letrare shqipe dhe shkrimin e saj,
- * të mos ketë pengesa në të shprehurit gojor,
- * të jetë komunikativ dhe i hapur për bashkëpunim,
- * të ketë përgatitje përkatëse profesionale, me ose pa përvojë pune,
- * ta dojë punën pedagogjike dhe të përparojë në këtë profesion,
- * të jetë organizator i mirë, kreativ dhe i aftë për të zbatuar risi në metodologjinë mësimore etj .

6.2. NORMATIV I KUADRIT MËSIMDHËNËS

Lëndën e gjuhës dhe letërsisë shqipe me komunikim në shkollat e mesme profesionale mund ta mbajnë mësuesit që kanë kryer:

1. Fakultetin Filologjik, Grupin e Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe (drejtimi arsimor)
2. Fakultetin Filozofik, Grupin e Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe (drejtimi arsimor)
3. Fakultetin Filozofik, Grupin e Gjuhës dhe Letërsisë shqipe (drejtimi arsimor)

7. KOHA E PËRGATITJES DHE BARTËSI I PROGRAMËS: MËSIMORE

7.1. Data e hartimit të programit , maj 2001

7.2. Përbërja e ekipit profesional

1. Selver Ramadani- këshilltar në Birone për Zhvillimin e Arsimit-bartës
2. Dr. Zeqir Kadriu- zëvendës drejtor në Byronë për Zhvillimin e Arsimit.
3. Dr. Xhemaludin Idrizi- prof. i gjuhës dhe let. shqipe (drejtor në Gjimnazin " Zef Lush Marku" Shkup).
4. Dr. Nehas Sopaj - profesor në Fakultetin Filologjik, Katedra e Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe - Shkup.
5. Dr. Zeqirija Neziri – prof. në Fakultetin Filologjik –Katedra e gjuhës dhe letërsisë shqipe-Shkup
6. Qamile Saiti- profesororeshë në gjimnazin " Zef Lush Marku " Shkup.

8. FILLIMI I ZBATIMIT TË PROGRAMIT MËSIMOR

9. MIRATIMI I PROGRAMIT MËSIMOR

Programi i lëndës së Gjuhës Shqipe dhe Letërsi me komunikim u lejua të përdoret me vendimin numër _____
_____ të datës _____